



Dahlia



Estetiste për trajtimin e trupit dhe fytyrës

Përshkrimi i pozicionit të punës:

Dahlia është në kërkim të një estetisteje me eksperiencë, që të ketë njohuri të thella rreth trajtimeve dhe pajisjeve për fytyrën dhe trupin dhe të dijë të punojë mirë në grup. Estetistja, nëpërmjet njohurive të saj për biologjinë e lëkurës, anatominë dhe kiminë kozmetike, ofron një sërë trajtimesh për fytyrën dhe trupin për meshkuj dhe femra, të përshtatura sipas nevojës së klientit si edhe rekomandon produktet e duhura për kujdesin e mëvonshëm.

Detyrat kryesore:

- Të bëj check-up e lëkurës me pajisjen përkatëse dhe të këshillojë klientet për kujdesin ndaj lëkurës
- Të kryej trajtime të ndryshme të fytyrës sipas dëshirës dhe nevojës së klientit duke përdorur kur është e nevojshme edhe pajisjet e duhura
- Të kryej trajtime të ndryshme të trupit duke përdorur pajisjet e përshtatshme
- Të kryej masazhe të ndryshme të fytyrës dhe trupit (relaksuese, aromatherapy, me gura vullkanike, etj.)
- Të dijë të përdorë llampën pulsante për depilimin permanent, heqjen e njollave, etj.
- Të shesë dhe këshillojë klientët për produktet kozmetike

Cilësitë personale:

- Mos të ketë alergji nga produktet kozmetike
- Të ketë paraqitje të rregullt dhe të kuaruar
- Të jetë diskrete në lidhje me trajtimet që i ofron klientëve
- Të ketë aftësi të mira komunikuese

Kualifikimet profesionale:

- Të ketë përfunduar me sukses shkollimin e duhur për estetikë
- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë
- Gjuhët e huaja janë një aset që do të merret në konsideratë

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervista.

*Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre me foto në adresën e e-mail-it dahliacenter@hotmail.com duke specifikuar pozicionin për të cilin po aplikojnë, **deri në datën 19 Shkurt 2016.***

Dahlia. Feel Better!